



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	15.02.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DLK-3113/15
PËR/ZA/TO:	z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit
CC:	z. Isa Mustafa, Kryeministër i Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion

I nderuari z. Krasniqi,

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) sipas detyrës zyrtare ka filluar procedurën e hetimeve paraprake lidhur me emërimin e një numri të madh të Drejtorëve në Bordet e Ndërmarrjeve Publike (NP) në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake si dhe ekzaminimit të dokumentacionit përkatës të siguruar nga Zyra e Kryeministrit, analiza e bërë nga grup i OJQ-ve¹, si dhe analiza e bazës ligjore në fuqi që ka të bëjë me emërimet në Bordet e NP, ka vërejtur se për drejtor të shumë Ndërmarrjeve Publike Qendrore (NPQ)² janë emëruar persona të cilët bazuar në dispozitat e ligjit për NP nuk mund të ushtrjnë një funksion të tillë.

Prandaj, duke parë trendin e emërimeve për drejtor të Bordeve në NP në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe me qëllim të korrektimit të këtij procesi, duke u mbështetur në mandatin e saj të paraparë me ligj AKK nxjerr:

¹ INDEP, GAP, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, etj.

² Shih listën e NP-ve në të cilat drejtorët nuk janë zgjedhur në përputhje me kërkesat ligjore.

OPINION

I. Baza Ligjore për këtë opinion

Neni 5 (Paragrafi 1 pika 1.12) i Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Neni 19 (Paragrafi 1 pika 1.6), Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike si në vijim:

Neni 17, Paragrafi 2, pika k, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i cili thekson:

17.2 Të gjithë drejtorët përveç KE duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike”

Neni 17, Paragrafi 2, pika k, Ligji për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar me Nenin 2 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike definicionet në vijim:

“Zyrtar i zgjedhur publik” - nënkupton individin i cili e ushtron një post publik, të cilin e ka fituar përmes zgjedhjeve.

“I emëruar politik” - nënkupton personin i cili është emëruar, ose propozuar nga subjekti politik si kandidat për një post të zgjedhur.

Neni 17, Paragrafi 5, Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 i cili thekson:

“Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit”.

II. Vlerësimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Nga analiza e dokumentacionit të siguruar lidhur me këtë rast, AKK ka vërejtur se:

1. Komisionet Rekomanduese të caktuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, për anëtarë (drejtor) të Bordeve NP kanë rekomanduar persona të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara me dispozitat e Nenit 17, Paragrafi 2, pika k, Ligji për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar me Nenin 2 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
2. Me rekomandim të këtyre komisioneve të njëjtit persona më pas janë emëruar nga ana e Kryeministrit të Republikës së Kosovës për anëtarë (drejtor) në Bordet e NP.³
3. Sipas konkursit të publikuar për drejtor të Bordeve të NP kandidatët është dashur të dorëzojnë ndër të tjera edhe deklaratën nën betim (Formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit). Ky formular i deklaratës nën betim i cili është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit nuk është i përgatitur në harmoni me dispozitat e Nenit 17 paragrafi 5 Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në të cilin theksohet se: *“Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni.*
4. Përkufizimi i dhënë në formularin e Deklaratës nën betim të përgatitur nga Zyra e Kryeministrit nuk është në përputhje me kërkesat e Nenit 17, Paragrafi 2, pika k, Ligji për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar me Nenin 2 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Formulari i deklaratës nën Betim të përgatitur nga ZKM ndër të tjera thekson: *“nuk jam i emëruar politik (këshilltar politik i emëruar me vendim politik dhe i emëruar në ekzekutivin e Komunës sipas një vendimi pa kaluar procesin e konkursit”*. Ky përkufizim është më i ngushtë se sa ai që përfshihet në dispozitat e ligjit të cilat të emëruarit politik i përkufizojnë: *“I emëruar politik” - nënkupton personin i cili është emëruar, ose propozuar nga subjekti politik si kandidat për një post të zgjedhur.*⁴
5. Në konkurs ishin të parapara edhe kushtet kur personi ka të drejtë të shërbejë si drejtor në bordin e NPQ: *nëse nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim, si dhe atë kur kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në bordin e NPQ nëse: është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë zyrtarë i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike.*

³ Shih pikën III të këtij opinioni: *III. Lista e Ndërmarrjeve Publike*, në të cilat janë emëruar drejtor në kundërshtim me dispozitat e LNP.

⁴ Neni 2, Ligji për Ndërmarrjet Publike.

III. Lista e ndërmarrjeve Publike

Gjatë analizës së dokumentacionit AKK ka vërejtur se në ndërmarrjet publike në vijim janë bërë emërimet të anëtarëve të bordeve (drejtorëve) në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike:

1. Aeroporti i Gjakovës, SH.A.
2. Hekurudhat e Kosovës, INFRAKOS, SH.A.,
3. Hekurudhat e Kosovës, TRAINKOS, SH.A.,
4. Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidrodrini, SH.A., Pejë,
5. Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica SH.A., Mitrovicë,
6. Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi, SH.A., Gjakovë,
7. Korporata Energjetike e Kosovës, (KEK), SH.A.,
8. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut SH.A. (KOSTT),
9. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) SH.A.,

IV. Rekomandim

1. Formulari i Deklaratës nën betim të ndryshohet dhe të hartohet në harmoni me dispozitat ligjore të cekura më lartë për emërimet tjera të ardhshme.
2. Zyra e Kryeministrit duhet të ndërmarrë masat e parapara me nenin 17.5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndaj personave të cilët kanë dhënë deklarata të rrejshme nën betim.
3. Zyra e Kryeministrit duhet të ndërmarrë masa ndaj zyrtarëve që kanë hartuar Formularin e Deklaratës së tillë nën Betim e cila nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

AKK është e gatshme të bashkëpunoj me Zyrën e Kryeministrit me qëllim të zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Me respekt!